

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca plenare

Seanca nr. 02-30/17-06

Prishtinë, më 31 gusht 2006, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

Seancën në fillim e kryesoi **Kolë Berisha**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Mahir Yagcilar**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 95 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

REND DITE:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të 27 korrikut 2006,
3. Koha për pyetje parlamentare,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për adoptimin e Konventës së Këshillit të Evropës për krimin në fushën e kibernetikës,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kontrollin e cilësisë së produkteve gjatë importit dhe të eksportit,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për energjinë – nr.2004/8,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rregullatorin e energjisë – nr.2004/9,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e bimëve,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e varieteve të bimëve,

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kadastër – nr. 2003/5,
11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shpronësimet për interesa publike.

Kryetari i njoftoi të pranishmit se të gjitha materialet e nevojshme për këtë seancë u janë shpërndarë deputetëve të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare nuk ka arritur asnjë propozim me shkrim për ta plotësuar rendin e ditës, të propozuar nga Kryesia e Kuvendit. Ai kërkoi që të procedohet sipas propozimit të Kryesisë.

1. Miratimi i rendit të ditës

Alush Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, kërkoi që të hiqet pika e pestë e rendit të ditës.

Ministri **Bujar Dugolli** tha se pajtohet me propozimin e Alush Gashit dhe me sugjerimin e Komisionit Funkcional që materia e normuar me këtë projektligj mund të rregullohet edhe me ndonjë akt nënligjor.

Kuvendi miratoi rendin e ditës të kësaj seance, të propozuar nga Kryesia, për heqjen e pikës së pestë.

2. Miratimi i procesverbali të seancës plenare të 27 korrikut 2006

Procesverbali i seancës plenare të 27 korrikut 2006 u miratua pa vërejtje.

3. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja **Zylfije Hundozi** i kishte parashtruar pyetje ministrit të Ekonomisë dhe të Financave lidhur me çështjet financiare në shëndetësi.

Ministri Haki Shatri nuk ishte i pranishëm për t'iu përgjigjur deputetes Hundozi. Pyetja e deputete Hundozi duhet të publikohet ne Buletin e Kuvendit.

Deputetja **Zylfije Hundozi** i parashtrroi pyetje ministrit të Tregtisë dhe të Industrisë lidhur me parandalimin e “ekonomisë gri” në Kosovë.

Ministri **Bujar Dugolli** u përgjigj pyetjes së deputetes Hundozi.

Deputeti **Ramadan Kelmendi** i parashtrroi pyetje ministrit të Punëve të Brendshme lidhur me qarkullimin e automjeteve me targa të vjetra dhe pa tagra, në pjesën Veriore të Mitrovicës.

Ministri **Fatmit Rexhepi** u përgjigj pyetjes së deputetit Kelmendi.

Deputeti **Ramadan Kelmendi** i parashtroi pyetje ministrit për Kthim dhe për Komunitete lidhur me kthimin e shqiptarëve në pjesën veriore të Mitrovicës.
Ministri Slavisha Petković nuk ishte i pranishëm. Mbetet për t'iu përgjigjur për seancën e radhës.

Deputetja **Gjylshene Berisha** i parashtroi pyetje ministrit të Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor lidhur me projektet e kësaj Ministrie për trajtimin e ujërave të zeza në komunën e Gjilanit

Ministri **Ardian Gjini** u përgjigj pyetjes së deputetes Berisha.

Deputeti **Nait Hasani** i parashtroi pyetje ministrit të Transportit dhe të Postë-Telekomunikacionit lidhur me anulimin e tenderit për sinjalizimin e rrugëve.

Ministri **Qemajl Ahmeti** u përgjigj pyetjes së deputetit Hasani.

Deputeti **Nait Hasani** i parashtroi pyetje ministrit të Tregtisë dhe të Industrisë lidhur me njohjen e dokumenteve të kësaj ministrie nga ana e KRRPP-së..

Ministri **Bujar Dugolli** u përgjigj pyetjes së deputetit Hasani.

Deputeti **Hydajet Hyseni** përsëriti pyetjen e parashtruar më parë për ministrin e Pushtetit Lokal lidhur me shpenzimin e mjeteve për sanimin e pasojave të tërmetit në komunën e Gjilanit.

Ministri **Lutfi Haziri** nuk ishte i pranishëm. Pyetja duhet të botohet në Buletinin e Kuvendit të Kosovës.

Deputeti **Berat Luzha** i parashtroi pyetje kryeministrit të Kosovës lidhur me pezullimin e Ligjit për lojërat e fatit.

Kryeministri **Agim Çeku** u përgjigj pyetjes së deputeti Luzha.

Deputeti **Genc Gorani** i parashtroi pyetje ministrit të Punëve të Brendshme lidhur lejimin e operatorëve ilegal të telefonisë mobile në Kosovës.

Ministri **Fatmir Rexhepi** u përgjigj pyetjes së deputeti Gorani.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për adoptimin e Konventës së Këshillit të Evropës për krimin në fushën e kibernetikës

Kryetari e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri, **Qemajl Ahmeti**, në emër të Qeverisë së Kosovës, e arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri.

Në vazhdim ministri **Ahmeti i** paraqiti qëllimet, objektivat dhe mënyrën e zbatimit të këtij projektligji. Ai i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratonin atë.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga ministri Qemajl Ahmeti, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Milazim Haliti, Hatixhe Hoxha, Ymer Halimi, Nazim Jashari, Nuran Malta, Hydajet Hyseni dhe Nekibe Kelmendi**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 54;

Kundër----- 1.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës e **miratoi në parim** Projektligjin për adoptimin e Konventës së Këshillit të Evropës për krimin në fushën e kibernetikës.

Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion - Komision Përgjegjës - Raportues - ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për energjinë – nr.2004/8

Kryetari e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri **Et'hem Çeku**, në emër të Qeverisë së Kosovës, e arsyetoi nevojën për ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji.

Në vazhdim ministri **Çeku** tha se me ndryshimet e propozuara në këtë projektligj synohet inkurajimi dhe përsheptimi i investimeve private në sektorin e energjisë, Bashkëpunimin dhe zhvillimet rajonale në sektorin energjetik siç është: Marrëveshja për themelimin e Bashkësisë së Energjisë në Evropën Juglindore.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga ministri Çeku, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Fadil Gashi, Bajrush Xhemajli, Mazllom Kumnova dhe Genc Gorani**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 70;

Kundër----- 4.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës e **miratoi në parim** Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për energjinë – nr.2004/8

Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion - Komision Përgjegjës - Raportues - ta shqyrtojë këtë projektligj brenda dy muajve dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Rregullatorin e Energjisë – nr. 2004/9

Kryetari e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri, **Et'hem Çeku**, në emër të Qeverisë së Kosovës, e arsyetoi nevojën për ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji.

Në vazhdim ministri, **Çeku** tha se synimi kryesor i ndryshimit dhe i plotësimit të këtij ligji është krijimi i një mekanizmi gjithëpërfshirës, që do të sigurote proces të drejtë gjithëpërfshirës, transparent dhe jodiskriminues. Parashihet themelimi i Komisionit tenderues për projektet e energjisë, i përbërë nga përfaqësuesit e Ministrisë së Energjisë dhe të Minierave, zëvendësi i PSSP-së për ekonomi, Zyra e kryeministrit, Ministria e Ekonomisë dhe i Financave, Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, kryesuesi i Bordit të Zyrës së Rregullatorit, kryesuesin e Bordit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale. Me këto propozime përcaktohen qartë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit tenderues të projektit, Zyrës së Projektit dhe Zyrës së Rregullatorit të energjisë.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga ministri Çeku, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Ibush Jonuzi, Bajrush Xhemajli, Mazllom Kumnova, Genc Gorani dhe Jakup Krasniqi**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 46;

Kundër----- 24.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës e **miratoi në parim** Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Rregullatorin e Energjisë – nr. 2004/9.

Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetik, Transport dhe Telekomunikacion - Komision Përgjegjës - Raportues - që ta shqyrtojë këtë projektligj brenda dy muajve dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e bimëve

Kryetari e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Zëvendësministri, **Tomë Hajdaraj**, në emër të Qeverisë së Kosovës, e arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri.

Në vazhdim zëvendësministri, **Tomë Hajdaraj**, tha se qëllimi i këtij projektligji është krijimi i kornizës ligjore për parimin e mbrojtjes së bimëve, të produkteve bimore, për një siguri më të madhe të mbrojtjes së bimëve në Kosovë dhe me shtesë në të gjitha fazat në prodhim, përpunim, deponim, shpërndarje të bimëve edhe të tjera. Projektligji është i përbërë prej 13 kapitujve, prej dispozitave të përgjithshme deri tek ato përfundimtare.

Nuk ka implikime buxhetore për zbatimin e këtij ligji, sepse trupat përgjegjës për zbatimin e tij janë të formuar dhe të gjithë të punësuarit paguhen nga Buxheti i konsoliduar i Kosovës.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga zëvendësministri, Tomë Hajdaraj, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Jusuf Sutaj, Berat Luzha, Myrvete Dreshaj-Baliu dhe Gazmend Muhaxheri**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 63;

Kundër----- 2.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës e miratoi në parim Projektligjin për mbrojtjen e bimëve.

Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor - Komision Përgjegjës - Raportues – që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kadastër – nr. 2003/5

Kryetari e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministrja **Melihate Tërmkoll**i në emër të Qeverisë së Kosovës, e arsyetoi nevojën për ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji.

Në vazhdim ministrja, **Tërmkoll**i tha se synimi kryesor i ndryshimit dhe i plotësimit të këtij ligji është të ndryshohet në ato pjesë ku ka pasur vështirësi gjatë zbatimit të tij në

praktikë dhe të plotësohet me çështje të tjera, që nuk ishin paraparë në dispozitat e Ligjit për kadastrën të miratuar në vitin 2003.

Në nenin 5 ndryshohet nenin 29.1. të Ligjit për kadastrë, me të cilin rregullohet mënyra e rindërtimit të informacioneve kadastrale. Ndryshimi konsiston në atë se me nenin 29.1. të Ligjit për kadastrë nuk janë përfshirë edhe ndërtesat, dhënia e garancive palëve, të interesuara se kufijtë kadastralë përcaktohen në bazë të kërkesës së pronarëve të interesuar dhe duke i nënshkruar procesverbalin për pranimin e gjendjes së re në terren.

Për zbatimin e këtij ligji nuk ka shpenzime shtesë dhe nuk nevojiten mjete financiare.

Pas arsytimit të këtij projektligji nga ministrja Tërmkollli, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Ramadan Kelmendi, Hajredin Hyseni, Myrvete Dreshaj-Baaliu, Gazmend Muhaxheri dhe Xhezair Murati**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 70;

Kundër----- 2.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës e **miratoi në parim** Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kadastrë – nr. 2003/5.

Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media - Komision Përgjegjës - Raportues – që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe t’ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e varieteve të bimëve

Kryetari e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Zëvendësministri, **Tomë Hajdaraj**, në emër të Qeverisë së Kosovës, e arsyetoi nevojën e normimit të kësaj fushe me ligj të ri.

Në vazhdim zëvendësministri **Tomë Hajdaraj** tha se ky Projektligj siguron kushtet elementare dhe qenësore për mbrojtjen e varietetet të të gjitha gjinive dhe llojeve bimore, duke përfshirë edhe kryqëzimet në mes gjinive dhe llojeve të bimëve të ndryshme. Projektligji ka një strukturë complete, gjithëpërfshirëse dhe përmbajtësore, të shtjelluar në njëmbëdhjetë kapituj dhe është hartuar sipas teknikës juridike bashkëkohore, në harmoni me standardet dhe me Direktivat e UE-se.

Për zbatimin e këtij projektligji nuk ka implikime financiare, sepse organet e parapara për implementimin e tij tashmë ekzistojnë.

Pas arsytimit të këtij projektligji nga zëvendësministri, Tomë Hajdaraj, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Lulzim Zeneli, Sevdije Halimi, Myrvete Dreshaj-Baliu dhe Rifat Krasniq**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve kryetari e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 67;

Kundër----- 0.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës e **miratoi në parim** Projektligjin për mbrojtjen e varieteve të bimëve.

Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor - Komision Përgjegjës - Raportues – që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim.

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shpronësimet për interesa publike

Kryetari e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ibush Jonuzi, kryetar i Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion – sponsor i këtij projektligji – arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri.

Në vazhdim deputeti **Ibush Jonuzi** tha se me këtë projektligj për shpronësimet rregullohet raporti ndërmjet pronës private si një e drejtë themelore e njeriut, por ajo duhet të konsiderohet edhe si njëri prej elementeve kryesore që e mundësojnë krijimin dhe zhvillimin e një shoqërie të lirë dhe të orientuar nga ekonomia e tregut. Si e tillë prona private gëzon mbrojtjen më të lartë juridike. Mirëpo, në anën tjetër, prona private nuk mund të trajtohet e izoluar nga nevojat e shoqërisë dhe të jetë e paprekshme edhe atëherë kur shfrytëzimi i saj kërkohet për interes publik.

Shumë projekte të zhvillimit urbanistik të rregullimit hapësinor dhe të ndërtimit të infrastrukturës publike, si p.sh. ndërtimi i rrugëve dhe i magjistrave, i minierave dhe i termocentraleve, nuk mund të realizohen nëse nuk do të ekzistonte kjo mundësi ligjore. Mirëpo edhe në ato raste kur prona private kërkohet edhe në shërbim të interesit të përgjithshëm, pronari privat duhet të ketë mundësi për mbrojtje të mjaftueshme juridike dhe të kompensohet për humbjen e së drejtës së tij të pronësisë. Shikuar nga ky kënd gjetja e balancit ndërmjet interesave të pronarit privat dhe të atyre të shoqërisë, ofrimi i procedurave transparente dhe efektive, si dhe përcaktimi i kompensimit të drejtë janë qëllime kryesore të një ligji për shpronësimet.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga ana e sponsori, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Nerxhivane Dauti, Gjylnaze Syla, Nazim Jashari, Husnija Beshkoviq, Ramadan**

Kelmendi, Nekibe Kelmendi, Hydajet Hyseni, Alush Gashi, Sabri Hamiti, Naser Osmani, Gani Koci, Bajrush Xhemajli dhe Genc Gorani, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve kryetari e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 60;

Kundër-----15.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës e **miratoi në parim** Projektligjin për shpronësimet për interesa publike.

Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion - Komision Përgjegjës - Raportues – të cilin duhet ta ndihmojë një **Grup i ekspertëve** të kësaj fushe, i përbërë nga të gjitha grupet parlamentare, për ta përgatitur këtë projektligj dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime për miratim.

Shënim: Pjesë përbërëse e këtij procesverbali është transkripti i kësaj seance.

Kryetari e deklaroi seancën të mbyllur në orën 15:25 minuta.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës
Kolë BERISHA

E hartoi

Spektori për Çështje Plenare dhe Procedurale